

Procesverbali i takimit të mbajtur më 21 tetor 2020

Rendi i ditës

1. Rishikim i përgjithshëm i gjendjes së Kolegjit (rezyme nga takimi në qershor 2019)
2. Raport i Kryetarit të Këshillit Studentor Znjsh. Viola Brahusi mbi gjendjen e Kolegjit

Në takim u diskutua për gjendjen e Kolegjit kundrejt treguesve të cilësisë siç spikatet në Raportin Vjetor të brendshëm vetëvlerësues të Kolegjit ESLG bazuar në Manualin e Cilësisë së Kolegjit ESLG. Këshilli Studentor aprovoi draftin e Raportit të brendshëm vjetor të vetëvlerësimit, draftin e strategjisë për përmirësimin e cilësisë dhe draftin e Planit të Veprimit për Implementimin e Strategjisë së Përmirësimit të Cilësisë 2020. Këshilli Studentor gjithashtu aprovon draftin e jashtëm të raportit të jashtëm të vetëvlerësimit për programin e studimeve Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) i cili është objekt i procesit të akreditimit nga AKA.

Në takim, Këshilli Studentor rishikoi kurrikulumin e programit të ri të propozuar, rezultatet e mësimnxënies dhe miraton programin e propozuar nga Komisioni për Zhvillim të Kurrikulës.

Procesmbajtës: Kryetare e Këshillit Studentor

Znjsh. Viola Brahusi

